



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 63

2001

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK
nr.198, datë 19.12.2001

Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.863, datë 23.9.1999 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr.R-15, datë 21.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....

1947

Vendim i GJK
nr.205, datë 24.12.2001

Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.257, datë 14.7.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; nr.166, datë 10.10.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.51, datë 26.1.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....

1949

Vendim i GJK
nr.206, datë 24.12.2001

Me objekt shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën të pikave 5, 6 e 7 të udhëzimit nr.1, datë 23.2.1999 "Për kriteret e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.666, datë 26.10.1998 "Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore" nxjerrë prej Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit, si dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.....

1951

Vendim i GJK nr.207, datë 24.12.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.401, datë 25.4.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.X-4, datë 24.7.2001 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.	1953
Vendim i GJK nr.208, datë 24.12.2001	Me objekt papajtueshmërinë me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 4 të ligjit nr.8655, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë.....	1955
Vendim i GJK nr. 209, datë 24.12.2001	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.1305,datë 10.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë	1956

V E N D I M
Nr. 198, datë 19.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Zija Vuci	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 22.10.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.149 Akti që i përket:

KËRKUES: Refat Frashëri, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Sevin Peshkëpia etj. në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.863, datë 23.9.1999 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr.R-15, datë 21.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31 pika 1 dhe 42 të Kushtetutës.

Shfuqizimin e këtyre vendimeve kërkesi e ka kërkuar për këto shkaqe:

Në të dy këto instanca gjyqësore është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor. Kjo parregullsi, sipas tij, konsiston në faktin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar atij të drejtën e mbrojtjes me avokat, ndërsa Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara, duke mos e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, por duke vendosur në Dhomën e Këshillimit për mospranimin e rekursit, ka marrë atributë që nuk i takojnë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Zija Vuci, përfaqësuesin e kërkesit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr.632, datë 10.4.1998, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkesit Rifat Frashëri kundër subjektit të interesuar Sevin Peshkëpia etj. dhe e ka rrëzuar atë për pjesën tjetër, e cila kishte për objekt anulimin e vendimit nr.59, datë 21.11.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Vlorës dhe njohjen e të lartpërmendurit si pronar të një trualli me sipërfaqe 40 000 m² të ndodhur në vendin e quajtur "Uji i Ftohtë" Vlorë.

Mbi ankimin e këtij të fundit çështja është gjykuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me vendimin e saj nr.434, datë 13.10.1998 ka vendosur ndryshimin e vendimit të sipërm të Gjykatës së Rrethit Vlorë, dhe duke e gjykuar çështjen në fakt, ka rrëzuar padinë.

Kërkesi nuk ka qenë dakord me këtë zgjidhje dhe i është drejtuar me rekurs Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore në mungesë të kërkesit dhe të avokatit të tij dhe, me vendimin nr.863, datë 23.9.1999, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Ai përsëri e ka kundërshtuar me rekurs edhe këtë vendim të Kolegjit pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, por Kolegji Seleksionues i tyre, me vendimin nr.R-15, datë

21.12.2000, ka vendosur mospranimin e këtij rekursi si të pabazuar në ligj.

Ashtu siç ka parashtruar edhe kërkuesi, vendimet e këtyre Kolegjeve të Gjykatës së Lartë nuk janë rezultati i një procesi të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur në provat shkresore që ndodhen në dosjen gjyqësore, si dhe në provat e tjera të administruara në seancë plenare, arrin në përfundimin se parregullsia e këtyre proceseve është shfaqur në këto drejtime:

Në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë gjyqi është zhvilluar pa pjesëmarrjen e avokatit të kërkuesit. Mosparaqitja e tij në seancë gjyqësore ka ardhur për shkaqe të arsyeshme, sepse ditën e gjykimit ai ka munguar për shkak se ka qenë i sëmurë, fakt i cili vërtetohet me raportin mjekësor që ndodhet në dosje.

Në këto rrethana, Kolegji Administrativ duhej ta shtynte gjykimin për një ditë tjetër dhe jo ta gjykonte çështjen në mungesë të avokatit të kërkuesit. Kjo mënyrë gjykimi është mohim i të drejtës të mbrojtjes, e cila, si e drejtë themelore, garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Dhunimi i kësaj të drejte jo vetëm i ka hequr mundësinë kërkuesit të gëzojë një mbrojtje të specializuar, por ka sjellë edhe shkeljen e parimit të kontradiktoritetit. Kjo shkelje ka të bëjë me faktin se kërkuesi në këtë proces nuk është vënë në kushte barazie me palën tjetër. Ndryshe nga kjo e fundit, e cila ka qenë e mbrojtur me avokat dhe ka parashtruar pretendimet e veta rreth problemeve që kanë lindur gjatë këtij gjykimi, kërkuesit, jo për fajin e tij, por për shkaqe që nuk vareshin nga ai, nuk i është krijuar një mundësi e tillë.

Këto shkelje, të cilat janë ngritur nga kërkuesi në rekursin drejtuar Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë shoqëruar edhe procesin gjyqësor të zhvilluar nga Kolegji Seleksionues i tyre.

Konkluzioni i Kolegjit Seleksionues se rekursi drejtuar Kolegjeve të Bashkuara nuk përmban shkaqe ligjore është i pabazuar. Përkundrazi, i vetmi shkak për të cilin është ankuar kërkuesi ndaj vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është mosrespektimi nga ana e këtij e rregullave procedurale që garantojnë të drejtën e mbrojtjes në gjykim, si e drejtë kushtetuese.

Pra, në këtë rekurs kërkuesi ka ngritur një problem ligjor të mirëfilltë, zgjidhja e të cilit është atribut vetëm i Kolegjeve të Bashkuara në seancë gjyqësore dhe jo i Kolegjit Seleksionues në Dhomën e Këshillimit. Prandaj, ezaurimi i çështjes nga ky i fundit me mospranim të këtij rekursi është shkelje e rregullave mbi kompetencën. Kjo shkelje është pasuar edhe nga shkelje të tjera që e kanë privuar kërkuesin nga e drejta për të organizuar një mbrojtje të përshtatshme, e cila mund të realizohet vetëm në një gjykim kontradiktor të zhvilluar në seancë të rregullt gjyqësore.

Shmangia e këtij gjykimi nga ana e Kolegjit Seleksionues dhe zgjidhja që ai i ka dhënë çështjes me mospranim të rekursit në Dhomën e Këshillimit, ku nuk është e lejuar pjesëmarrja e palëve që janë në konflikt, përbën rastin tipik të një procesi jo të rregullt ligjor në vështirësi të nenit 42/1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 132 të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumcë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.863, datë 23.9.1999 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr.R-15, datë 21.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr. 205, datë 24.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 11.10.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.129 Akti që i përket:

KËRKUES: Altin Koçova, përfaqësuar nga avokat Spiro Kaso.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokurori i Përgjithshëm, përfaqësuar nga Arqile Lole.

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.257, datë 14.7.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr.166, datë 10.10.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.51, datë 26.1.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e sipërcituara janë rezultat i zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor nga ana e gjykatave dhe për shfuqizimin e tyre si antikushtetues ka parashtuar këto shkaqe kryesore:

- Është shkelur neni 31 shkronja "d" e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, që sanksionon një ndër garancitë kushtetuese të të pandehurit lidhur me të drejtën e tij në procesin penal për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve për të sqaruar rrethanat dhe faktet në ngarkim të tij. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, që ka hequr dorë nga thirrja dhe pyetja e dëshmitarëve dhe ekspertëve, përbën një mohim të së drejtës së mbrojtjes në proces.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtim paraprak, ka argumentuar fajësinë e të pandehurit dhe drejtësinë e masës së dënimit të dhënë ndaj tij, duke vendosur moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërkohë që shkaqet e parashtuara në rekurs ishin ligjore dhe që nuk i jepnin të drejtë Kolegjit në Dhomën e Këshillimit të bënte vlerësimin e tyre në themel. Ky qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Lartë është konsideruar shkelje e procesit të rregullt ligjor nga praktika e Gjykatës Kushtetuese.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.257, datë 14.7.2000, ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor dhe e ka dënuar me 5 vjet burgim, duke i dhënë pjesën e pavuajtur të dënimit me kusht. Mbi bazën e ushtrimit të ankimit nga prokurori, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.166, datë 10.10.2000, e ka ndryshuar vendimin në llojin dhe masën e dënimit për të pandehurin me 8 vjet burgim, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet të cilës kërkon shfuqizimin e të tre vendimeve të sipërcituara.

Nga shqyrtimi i çështjes në seancë plenare, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e ngritura nga kërkuesi nuk qëndrojnë. Pavarësisht se argumentet që kërkuesi ka parashtuar para Gjykatës Kushtetuese, në kuptimin formal, lidhen me qëndrimin dhe jurisprudencën e ndjekur prej saj, ato nuk mund të vlerësohen të shkelputura, por duhen analizuar për çdo rast konkret për të evidentuar ndikimin që mund të kenë patur në shkeljen e të drejtës kushtetuese të individëve për një proces të

rregullt ligjor.

Në mënyrën se si janë parashtruar nga kërkuesi shkaqet në rekurs, si dhe nga përmbajtja e tyre, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me të drejtë ka konkluduar duke arsyetuar se shkaqet e paraqitura nuk lidhen me kuptimin që përmban neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Nga ky vlerësim që i ka bërë Kolegji Penal në Dhomën e Këshillimit shkaqeve të ngritura në rekurs nuk rezulton të jenë zëvendësuar apo marrë padrejtësisht kompetencat e Kolegjit në seancë gjyqësore. Nga ana tjetër, veprimtaria e Kolegjit Penal në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, duke iu referuar dispozitave procedurale, nuk mund të kuptohet si një vlerësim i thjeshtë sipërfaqësor dhe formal që ai duhet t'i bëjë këtyre shkaqeve. Sipas nenit 433 të Kodit të Procedurës Penale, është kompetencë e Kolegjit Penal në Dhomën e Këshillimit të analizojë dhe vlerësojë përputhjen me kërkesat e ligjit të shkaqeve të ngritura me rekurs. Kjo analizë që bën Kolegji nuk mund t'ia heqë atij të drejtën për të vendosur mospranimin e rekursit, kur bindet se shkaqet e ngritura në rekurs lidhen me mënyrën e të vlerësuarit të provave nga gjykatat e hallkave më të ulta. Gjithashtu, kur Kolegji në Dhomën e Këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë i përket atij të vlerësojë dhe të vendosë konform kërkesave të ligjit për moskalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Këto veprime nuk janë të njëllajta dhe nuk mund të konfondohen me rastet kur jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se Kolegjet e Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit kanë mohuar ekzistencën e shkaqeve ligjore, ndërkohë që këto shkaqe kanë qenë prezente në dosje, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e dëgjimit dhe të mbrojtjes, të cilat lidhen pazgjidhshmërisht me të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor.

Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese për çështje të ndryshme, si dhe qëndrimeve të mbajtura, të cilat vlerësohen për çdo rast konkret, pasi këto vendime kanë efekte inter partes, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se nuk është qëllimi i saj të orientojë dhe të vërë detyra në një praktikë të saj më të konsoliduar për t'i dhënë kuptimin kushtetues të drejtës së individëve për një proces të rregullt ligjor.

Pretendimi tjetër i kërkuesit, lidhur me argumentimin e fajësisë që Kolegji Penal në Dhomën e Këshillimit ka bërë në arsyetimin e vendimit, nuk përbën argument për pranimin e kërkesës. Kjo mënyrë e të arsyetuarit të vendimit të Kolegjit Penal në Dhomën e Këshillimit nuk është atribut i tij, por ajo duhet analizuar lidhur ngushtë me argumentin e ekzistencës së shkaqeve ligjore.

Përderisa për shkaqet e ngritura në rekurs Gjykata Kushtetuese bindet se, në rastin konkret, Kolegji Penal, duke i konsideruar të papajtueshme me kërkesat e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka cenuar ndonjë element të procesit të rregullt ligjor, sepse në fakt nuk është ai që ka përcaktuar fajësinë e të pandehurit, atëhere është i mjaftueshëm ky argument për të rrëzuar pretendimin e kërkuesit për antikushtetueshmërinë e vendimit të Kolegjit Penal.

Për pretendimin e kërkuesit, që konsiston në shkeljen nga ana e gjykatave të nenit 31 shkronja "d" të Kushtetutës, lidhur me mospyetjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve, të cilët mendohen, sipas tij, se kanë patur rëndësi për sqarimin e rrethanave dhe të fakteve, Gjykata Kushtetuese çmon të domosdoshme të ritheksojë se mbetet detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të vlerësuar në kuadrin e të gjithë provave të tjera rëndësishme e marrjes ose jo të tyre. Në pozicionin që mban Gjykata Kushtetuese në raport me gjykatat e zakonshme, konkludon se një pretendim i tillë i kërkuesit që ka të bëjë me mënyrën e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, të cilat i përkasin problemeve që lidhen me themelin e çështjes, nuk përbën juridiksion kushtetues.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 206, datë 24.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 19.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.189 Akti që i përket:

Kërkues: Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarëve "Pronësi me drejtësi", përfaqësuar nga avokat Pirro Totozani dhe anëtar i Shoqatës Gëzim Boçari, me autorizim.

Subjekte të interesuara:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
2. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT, përfaqësuar nga zotërinjtë Diana Zoto e Fatos Gjini, me autorizim.
3. MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT, përfaqësuar nga zotërinjtë Zamir Stefani e Genc Çelo, me autorizim.
4. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, përfaqësuar nga znj.Lefteri Lleshi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i pikave 5, 6 e 7 të udhëzimit nr.1, datë 23.2.1999 "Për kriteret e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.666, datë 26.10.1998 "Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve e të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore", nxjerrë prej Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit, si dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 41/2, 42, 124, 131, 134/f).

Për shfuqizimin e këtyre pikave të udhëzimit, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

1. Përmbajtja e pikave 5, 6 dhe 7 të udhëzimit, objekt i kësaj kërkesë, vijnë në kundërshtim me nenet 4, 15, 17, 41, 122/2 e 181/2 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore.

2. Duke pasur parasysh se udhëzimi është i ndërvarur dhe i lidhur me disa vendime të Këshillit të Ministrave të dala gjatë viteve 1992-1996, kërkohet shqyrtimi dhe shfuqizimi edhe i këtyre akteve.

3. Dispozitat që kundërshtohen i japin mundësi shtetit që truallin e të shpronësuarëve t'ua shesë personave të tretë, në kundërshtim me parimin kushtetues që mbron në radhë të parë ish-pronarin.

GJYKATA KUSHTETUESE:

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara, si dhe analizoi çështjen në tërësi

V Ë R E N:

Sipas nenit 50 të këtij ligji, kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre.

Kërkesa për shfuqizim edhe të akteve normative që lidhen me udhëzimin nr.1, datë 23.2.1999 dhe që i takojnë periudhës nga viti 1992 deri në vitin 1996 nuk e përmbush këtë kriter ligjor, prandaj nuk mund të merret në shqyrtim.

Në seancën gjyqësore të datës 19.11.2001, përfaqësuesi i kërkuarit, në lidhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666, datë 26.10.1998 "Për disa masa lidhur me procesin e likuidimit të ndërmarrjeve të varësisë së ish-Agjencisë Qendrore të Ristrukturimit dhe Privatizimit të Ndërmarrjeve Bujqësore", u shpreh se po të shfuqizohen pikat 5, 6 dhe 7 të udhëzimit objekt kërkesë, bie automatikisht ky vendim i Këshillit të Ministrave. Një shprehje e tillë nuk mund të merret si shtesë e objektit të kërkesës për shfuqizim edhe të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, në një kohë që nuk u paraqitën as shkaqet dhe argumentet që e bëjnë këtë vendim antikushtetues. Për më tepër, një kërkesë e tillë e bërë në seancë gjyqësore rezulton jashtë afatit ligjor të përmendur më lart, prandaj nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

Përsa i përket udhëzimit nr.1, datë 23.2.1999, Gjykata Kushtetuese konstaton se ai nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, prandaj në zbatim të nenit 117/1 të Kushtetutës nuk ka marrë fuqi juridike. Për rrjedhim, kërkesës së paraqitur i mungon objekti dhe si e tillë ajo duhet të rrëzohet.

Gjykata Kushtetuese, ka mbajtur një qëndrim të tillë edhe në vendimin e saj nr. 47, datë 7.7.1999 lidhur me kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.127, datë 28.3.1999, i cili nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare.

Duke konfirmuar këtë qëndrim ndaj një akti, i cili sipas Kushtetutës nuk ka marrë fuqi juridike, Gjykata Kushtetuese thekson se ky akt, që në momentin e hyrjes së tij, nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat është nxjerrë. Një akt i tillë nuk ka fuqi detyruese ndaj subjekteve apo personave të cilëve u drejtohet dhe këto ose çdo organ tjetër kanë të drejtë të mos përmbushin detyrimet apo urdhërimet që rrjedhin prej tij, pa qenë nevoja që për pavlefshmërinë e aktit të shprehet patjetër ndonjë organ shtetëror.

Veç kësaj, vihet në dukje se për këtë rast nuk janë zbatuar as kërkesat e nenit 118/1 të Kushtetutës, që aktet nënligjore të nxirren në bazë e për zbatim të ligjeve edhe pse ky fakt nuk ndikon në përfundimin si më sipër të çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr. 207, datë 24.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci	Anëtar i	'''
Gjergj Sauli	Anëtar i	'''
Alfred Karamuço	Anëtar i	'''
Kujtim Puto	Anëtar i	'''
Sokol Sadushi	Anëtar i	'''
Petrit Plloçi	Anëtar i	'''
Kristofor Peçi	Anëtar i	'''

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 19.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.190 Akti që i përket:

KËRKUES: Xhemaile Hoxha, përfaqësuar nga avokat Enver Qafmolla.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Hasim Bleta e Fatime Laci, përfaqësuar nga avokat Kujtim Capo.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.401, datë 25.4.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.X-4, datë 24.7.2001 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

Baza ligjore: Nenet 42/1 dhe 131/f të Kushtetutës.

Kërkuesi parashtron këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve:

1. Seanca gjyqësore në Gjykatën e Apelit është zhvilluar pa dijeninë e kërkuesit, për shkak se pjesëtarë të familjes së palës kundërshtare kanë ndihmuar për ndryshimin e datës së gjykimit dhe komunikimin jo sipas rregullave.

2. Në rigjykim gjykata e rrethit nuk ka zbatuar udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Lartë, duke shkelur nenin 486 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Megjithëse në rekurs janë ngritur këto shkaqe ligjore, si Kolegji Civil dhe ai seleksionues kanë vendosur mospranimin e rekursit, sepse ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkueses, të subjekteve të interesuara, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesja Xhemaile Hoxha ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kundër dy vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimin e Pronave, si dhe ka kërkuar detyrimin e të paditurve Hasim Bleta e Fatime Laci ta njohin pronar të një trualli me sipërfaqe 6000 m2.Me vendimin nr.780, datë 29.6.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.467, datë 10.10.2000. Ndërsa Kolegji Civil dhe Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë, me vendimet e tyre nr.401, datë 25.4.2001 dhe nr.X-4, datë 24.7.2001, kanë vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikojnë përkatësisht nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesja pretendon se në rekurs janë ngritur shkaqe ligjore, të cilat këto Kolegje, pa të drejtë, nuk i kanë marrë parasysh, pra kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor. Ky proces i parregullt, sipas kërkueses, konsiston në faktin se asaj pa të drejtë i është mohuar pjesëmarrja në gjykim në gjykatën e apelit dhe se në rigjykimin e çështjes gjykata e rrethit nuk ka zbatuar udhëzimet e lëna nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj që e kthente çështjen për rigjykim.

Lidhur me mosmarrëveshjen pjesë në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit, kërkuesja ka pretenduar se është bërë ndryshimi i datës së gjykimit dhe komunikimi i saj jo sipas rregullave ligjore.

Një pretendim i tillë nuk rezultoi i bazuar. Nga procesverbali i seancës së gjykimit të çështjes

në apel në datën 10.10.2000, i cili përkon me datën e vendimit, del se seanca është zhvilluar në mungesë të kërkuesses, e cila nuk është paraqitur pa ndonjë shkak, pasi data e gjykimit të çështjes ka qenë e shpallur sipas ligjit. Në këto kushte, gjykata e apelit ka zbatuar drejt ligjin lidhur me njoftimet për datën e gjykimit.

Kërkuessa pretendon se nga gjykata nuk u bë ekspertimi i një dokumenti, nuk u përcaktua vendndodhja e objekteve me grup ekspertësh të licencuar dhe nuk është pranuar kërkesa për caktimin e një grupi ekspertësh. Gjukata Kushtetuese nuk ka për detyrë të kontrollojë vendimet e gjykatave të zakonshme nga pikpamja e bazueshmërisë së tyre në prova, prandaj ky shkak i paraqitur në kërkesë nuk është i drejtë. Për më tepër, vendimi i Gjykatës së Lartë, që e kthen çështjen për rigjykim lidhur me ekspertimin, shprehet që ai të bëhet nëse shihet e nevojshme, pra e ka lënë në çmim të gjykatës që do të gjykojë çështjen.

Në rrethanat që përmendëm, problemet e ngritura nga kërkuessa në rekursin drejtuar Kolegjit Civil dhe Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë, nuk kanë qenë nga ato që parashikojnë nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile, prandaj, me të drejtë, këto Kolegje kanë vendosur mospranimin e rekursit.

Përfundimisht, Gjukata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE:

Gjukata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare

V E N D I M Nr. 208, datë 24.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjukata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Kristofer Peçi	Anëtar i “““

me sekretarët Noela Ruço e Arbenka Lalica, në datat 9.5.2001 dhe 21.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 34 Akti që i përket:

KËRKUES: SHOQATA KOMBËTARE E RADIOTELEVIZIONEVE, përfaqësuar nga avokat Ilir Panda, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, në mungesë.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

OBJEKTI: Papajtueshmëria me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 4 të ligjit nr.8655, datë 31.7.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 22, 131/a dhe 134/f të Kushtetutës dhe 27-31 e 49-51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Për shfuqizimin e këtyre paragrafëve të nenit 4 të ligjit kërkuesi parashtron këto shkaqe:

1. Kufizimi në dhënien e licencave për radion e televizionin vjen në kundërshtim me nenin 22 të Kushtetutës që përcakton se “Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar”.

2. Këto kufizime prekin lirinë dhe veprimtarinë ekonomike që parashikon neni 11 i Kushtetutës.

3. Duke parashikuar që të jepen vetëm 2 licenca për transmetim televiziv kombëtar dhe 4 për radio, këto paragrafë vijnë ndesh me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, që garanton lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesin e kërkuesit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, në datën 9.5.2001, përfaqësuesi i subjektit të interesuar të Kuvendit të Shqipërisë, kërkoi shtyrjen e gjykimit, sepse për ligjin në fjalë ishin propozuar disa ndryshime, ndër të cilat edhe ato lidhur me numrin e kufizuar të licencave për televizione dhe radio kombëtare.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.8794, datë 10.5.2001 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë””. Sipas ndryshimeve që u bënë, në nenin 4 të ligjit objekt kërkesë nuk pasqyrohen më kufizime për licenca për radiot dhe televizionet private kombëtare. Në këto kushte kërkesa mbeti pa objekt.

Meqenëse sipas kërkuesit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit nuk jep më asnjë licencë, kërkohet zëvendësimi i subjektit të interesuar të Kuvendit të Shqipërisë me subjektin “Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit” dhe ndryshimi i objektit të kërkesës për detyrimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit që të pajisë me licencë për transmetim televiz ose radioje subjektet e interesuara, të cilat i plotësojnë kriteret ligjore.

Kërkesa që u paraqit në seancë për vazhdim të gjykimit, duke ndryshuar subjektet dhe objektin e kërkesës, nuk ka bazë ligjore, prandaj Gjykata Kushtetuese, me vendim të ndërmjetëm, e rrëzoi atë. Kur kërkesës i ndryshon njëkohësisht si objekt, edhe subjektet e interesuara, ajo merr cilësinë e një kërkesë të re, ndërsa kërkesa e parë mbetet pa objekt. Në kushtet të tilla, Gjykata Kushtetuese është e detyruar që të vendosë pushimin e çështjes për mungesë të objektit të kërkesës. Lidhur me këtë vetë, kërkuesi parashtron në kërkesë se Kuvendi e ka kryer detyrën e tij, sepse e ka ndryshuar ligjin duke e përputhur atë me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M Nr. 209, datë 24.12.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 15.10.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.130 Akti që i përket:

KËRKUES: ARJAN KETA, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kora.

SUBJEKT I INTERESUAR:DIFTERE KETA, përfaqësuar nga Aurela Anastasi.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1305, datë 10.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin e këtij vendimi kërkuesi ka parashtruar si shkak:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shqyrtuar çështjen pa marrë njoftim unë si ndërgjyqës e për më tej pa iu komunikuar paraprakisht rekursi në interes të ligjeve që vuri në lëvizje këto kolegje.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Arjan Keta, që prej vitit 1992 e në vazhdim, ka pasur një konflikt gjyqësor me subjektin e interesuar Diftere Keta, me objekt lirim e dorëzim banese. Përfundimisht, me vendimin nr.952, datë 1.7.1998 të Gjykatës së Kasacionit është lënë në fuqi vendimi nr.5934, datë 24.11.1997 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, sipas të cilit banesa i përket kërkuesit.

Në datën 2.8.1999 subjekti i interesuar Diftere Keta ka ushtruar rekurs në interes të ligjit dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1305, datë 10.11.2000, kanë vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Kasacionit, si dhe të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe lirim të dorëzimit të banesës objekt konflikti Diftere Ketës.

Gjykata Kushtetuese vëren se pretendimi i ngritur nga kërkuesi, sipas të cilit rekursi i paraqitur nga subjekti i interesuar Diftere Keta nuk i është komunikuar, e për pasojë ai nuk ka pasur dijeni për shqyrtimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara, nuk mbështetet në provat e administruara e

të ndodhura në dosje, si dhe ato të siguruar nga kjo Gjykatë.

Gjykata e Lartë ka njoftuar kërkuesin për t'u paraqitur në atë Gjykatë, duke i dërguar telegramet me nr. D-16, datë 1.12.1999 dhe nr.39/0339, datë 9.6.2000 në emër të Arjan Ketës. Meqenëse ky nuk është paraqitur është dërguar telegrami i tretë me nr.38/0510, datë 18.6.2000 në emër të Dashamir Reçit, i caktuar si përfaqësues nga vetë kërkuesi.

Pas këtyre veprimeve, Gjykata e Lartë ka gjykuar çështjen. Nga shkresa nr.3382, datë 16.11.2001 e Albtelekomit, Filiali Tiranë, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, vërtetohet se të dy telegramet e fundit janë marrë nga të lartpërmendurit. Pas këtyre veprimeve është e drejta e palës ndërgjygjëse të vlerësojë nëse duhet të paraqitet ose jo në gjykatën që ka çështjen për gjykim. Fakti që palët nuk paraqiten për gjykim pas këtij momenti nuk e bën procesin jo të rregullt në kuptimin kushtetues.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë edhe pse kanë shqyrtuar rekursin në mungesë të avokatit të kërkuesit, mungesa erdhi nga mosveprimet e vetë kërkuesit e të përfaqësuesit të tij. Për pasojë nuk mund të pranohet pretendimi i ngritur nga kërkuesi se ndaj tij Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam për pranimin e kërkesës.

Në shqyrtimin e rekursit nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shkelur parimet bazë procedurale, ajo e kontradiktoritetit dhe e mbrojtjes, e për pasojë gjykimi ka qenë i parregullt në kuptim të nenit 42 pika 1 të Kushtetutës. Kjo doli mëse e qartë dhe e provuar në shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Kushtetuese, pavarësisht se shumica përpiket të argumentojë të kundërtën.

Ekzistenca ose jo e elementëve, që përbëjnë pakushtetutshmërinë në shqyrtimin e çështjes nga Kolegjet e Bashkuara, në rastin konkret është një çështje fakti, që zgjidhet lehtësisht vetëm nga analiza e provave të ndodhura në dosje dhe jo me hamendje. Në rastin në shqyrtim, fjala nuk është për provat që vërtetojnë ose jo themelin, por për ato dokumente e fakte që provojnë ose jo procesin e parregullt ligjor. Në këtë kuptim, edhe në procesin e kontrollit kushtetues shqyrtohen e vlerësohen prova, por natyrisht me specifikat që rrjedhin nga ky proces.

Në këtë vështrim, pakica tërheq vëmendjen në këto probleme që kanë të bëjnë me provat dhe që vërtetojnë katërcipërisht se kërkuesi nuk ka marrë dijeni për rekursin, për shqyrtimin e tij dhe për vendimin e marrë, deri në momentin kur atij i komunikohet ai (vendimi) për efekt ekzekutimi.

1. Në dosje nuk ka dokumente që të vërtetojnë se rekursi i është komunikuar kërkuesit ose përfaqësuesit të tij.

2. Shumica bën fjalë për dy telegrame të Gjykatës së Lartë, të cilat (sipas saj) u janë dorëzuar personave të lartpërmendur.

Në radhë të parë, nuk ka prova por vetëm hamendje lidhur me faktin nëse thirrja e kërkuesit dhe e përfaqësuesit të tij nga Gjykata e Lartë (me telegramet) kishte të bënte me komunikimin e rekursit apo ndonjë problem tjetër që s'lidhej fare me çështjen.

Shkresa e Filialit të Telekomit Tiranë, e cila bën fjalë për marrjen në dorëzim të telegrameve nga të interesuarit ka bashkëlidhur fotokopjet e dy dëftesave të komunikimit, të cilat, të para edhe me sy të lirë, nuk sjellin kurrësesi bindje se janë nënshkruar nga të lartpërmendurit.

Për të konkluduar se sa të dyshimta janë këto “lajmërime” shërben edhe fakti se nga tërësia e materialeve të dosjes del se Arjan Keta për një periudhë të gjatë banon familjarisht në Greqi.

Së fundi, do të ishte alogjike të mendohej se kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, edhe pse morën rekursin apo lajmërimin për atë, të ishin kaq të “painteresuar” sa të mos siguronin pjesëmarrje në shqyrtimin e çështjes për të mbrojtur atë ç’ka kishin fituar me vendimin e mëparshëm.

ANËTAR
A. Karamuço

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 31.12.2001
Doli nga shtypi më 31.12.2001

Tirazhi: 4230 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2001

Çmimi: 100 lekë